



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

| | | | |
|------------------|---------------------|---------------------|------------|
| Numri i Çështjes | 31155-02744-86-2018 | Data e Regjistrimit | 03/07/2018 |
| Numri i Vendimit | 86-2018-4476 | Data e Vendimit | 08/11/2018 |

VENDIM NE EMER TE REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit Tirane E PERBERE NGA:

KRYESUES: Amarildo Laçi
ANËTAR Alkelina Gazidedja
Bari Shyti
SEKRETARE Mimoza Lazri

Objekti: 1) Shfuqizimin teresisht si te paligjshem te Vendimit me Nr.140 date 11.05.2018 te Prokurores se ***** te ***** ***** *****
«Per pezullimin nga detyra te Prokurores *****, ne Prokurorine e Pergjithshme te Republikes se Shqiperise», deri ne perfundim te hetimeve ose gjykimit te procedimit penal me Nr.577/2018 te Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres.
2) Shfuqizimin teresisht si te paligjshem te Vendimit me Nr.141 date 11.05.2018 te Prokurores se ***** te ***** ***** *****
«Per pezullimin nga detyra te Prokurorit *****, ne Prokurorine prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane», deri ne perfundim te hetimeve ose te procedimit penal me Nr.577/2018 te Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres.
3) Pezullimin e zbatimit te Vendimit me Nr.140 date 11.05.2018 dhe Vendimit me Nr.141 date 11.05.2018 te Prokurores se ***** te ***** ***** ***** , deri ne perfundim te shqyrtimit, me vendim te formes se prere, te ankimit te bere nga ana e Prokuroreve ***** dhe ***** ndaj ketyre urdherave te paligjshem.

Baza Ligjore : Neni 6 i Konventes Europiane te Drejtave te Njeriut, nenet 31, 42, 49 dhe 179 pika 7 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, nenet 151, 154, 155 te Ligjit Nr.96/2016 «Per Statusin e Gjyqtareve dhe te Prokuroreve ne Republikën e Shqiperise», neni 34 i Kodit te Procedures Penale, Vendimi Unifikues i Gjykates se Larte me Nr.3/2002, Vendimi Unifikues i Gjykates se Larte me Nr.2/2013, nenet 21 dhe 67, 107, 109 germa «d», 113 te Ligjit Nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise», nenet 7, 10, 11, 15, 17 pika 1 germa «a», neni 18 pika 1 germa «b», 28, 29, 30 germa «a» te Ligjit Nr.49/2012 «Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreshjeve Administrative», nenet 189/1 germa «a» dhe 192/1 te Ligjit Nr.115/2016 «Per Organet e Qeverisjes se Sistemit te Drejtësisë», Vendimi Nr.2/2018 (JD) date 21.06.2018 i Kolegjit te Posacem te Apelitimit.

Përmbledhja e vendimit:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

**GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT,<?xml:namespace prefix = o ns =
"urn:schemas-microsoft-com:office:office"**

Në seancë gjyqësore, pasi dëgjo i përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, që kërkuan në diskutimet përfundimtare kërkuan:

Av. Eno Bushi, për paditësit, *** e ***** dhe personalisht paditësi *****:**
Pranimin e padisë. Shfuqizimin e vendimeve Nr. 140, datë 11.05.2018 dhe Nr. 141, datë 11.05.2018, të Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme, për pezullimin nga detyra të prokurorëve ***** e *****;

Znj. Pranvera Gruda, për palën e paditur, Prokuroria e Përgjithshme: Rrëzimin e padisë;

dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me normat ligjore relevante materiale e procedurale,

Vëren:v

V Ë R E N:<?xml:namespace prefix = o ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office"

Padia e prokurorëve ***** e ***** , është e bazuar në fakt e në të drejtë, ndaj ajo duhet pranuar, duke u vendosur shfuqizimi i vendimeve Nr. 140, datë 11.05.2018 dhe Nr. 141, datë 11.05.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, për pezullimin e tyre nga detyra.

I. Rrethanat e çështjes:

Paditësja ***** , në vitin 2002, është emëruar Prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8211, datë 31.05.2013, paditësja ***** , është emëruar Prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë.

Paditësi ***** , që prej vitit 2003 ka ushtruar funksionin e Prokurorit në Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lushnjë, Durrës, Elbasan dhe, prej datës 09.01.2018 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, ka regjistruar procedimi penal nr. 577, në ngarkim të shtetasve ***** , me detyrë prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë, si dhe ***** , me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për veprën penale "*Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i remë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, në formën e deklaramit të rremë, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal.

Me datë 08.05.2018 nga prokurorët e çështjes janë nxjerrë respektivisht Vendimet “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” për prokurorët ***** e ***** , duke i akuzuar për veprën penale të sipërcituar, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal.

Mbi informacionin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Durrës, për marrjen e cilësisë së të pandehurit nga paditësit, Prokurori i Përgjithshëm, me vendimet Nr. 140, datë 11.05.2018 dhe nr. 141, datë 11.05.2018, ka pezulluar nga detyra, respektivisht, paditësen ***** , prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe paditësin ***** , prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, deri në përfundim të hetimeve ose gjykimit të procedimit penal me Nr. 577/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Nëpërmjet vendimeve objekt padie, Prokurori i Përgjithshëm, duke iu referuar përcaktimeve të neneve 151 pika 1 germa “b” dhe 160 pika 2 germa “c” të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka vendosur pezullimin nga detyra të paditësve me motivacionin se, ata kanë marrë cilësinë e të bashkëpandehurve për një krim të rëndë të kryer me dashje.

Në pikën 5 të vendimeve të pezullimit është përcaktuar se: “Kundër tyre mund të bëhet ankim në Kolegjin e Apelimit, sipas nenit 179, pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.

Mbi ankimin e paditësve, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, me vendimin Nr. 2/2018 (JD), datë 21.06.2018, vendosi: “Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seance plenare”, duke arsyetuar se, në bazë të neneve 189/1, germa “a” dhe 192/1 të ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, këto vendime të Prokurorit të Përgjithshëm, janë akte administrative me karakter individual, që mund të ankimohen në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Në këto rrethana, paditësit, në datë 03.07.2018, i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit (Gjykata e Apelit/kolegji)me padinë objekt gjykimi, duke kërkuar krahas, shfuqizimit të akteve administrative, edhe pezullimin e tyre, deri në përfundim të gjykimit.

Gjyqtari kryesues i çështjes, në seancën përgatitore të datës 09.07.2018, mori vendim për refuzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, pezullimit të zbatimit të vendimeve Nr. 140, datë 11.05.2018 dhe Nr. 141, datë 11.05.2018, të Prokurores së Përgjithshme, në lidhje me pezullimin nga detyra e prokurorit të paditësve ***** e ***** .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

II. Pretendimet e paditësve, *** e *****:**

-

Paditësit, ***** e ***** , në padinë e paraqitur dhe gjatë gjykimit të saj, kanë parashtruar, si më poshtë:

1. Vepra penale qe i atribuohet dy Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, *** dhe ***** , nuk është një krim i rëndë.**

Sipas arsytimit të Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme, vepra penale e parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal, përbën krim të rëndë të kryer me dashje, për shkak të rëndësisë së posaçme të marrëdhënies juridike që cenohet, si dhe subjektit të veprës penale. Duke iu referuar vetëm llojit të veprës penale që përmendet në vendimet e Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme “Për pezullimin nga detyra” të paditësve, pa ditur faktin që përbën objekt akuze dhe asnjë konkluzion në lidhje me hetimet e kryera në ngarkim të ankuesve, rezulton se, vepra penale për të cilën është vendosur pezullimi i Prokurorëve ***** dhe ***** , nuk përbën një krim të rëndë.

Nga përcaktimet e neneve 1, 29, 31 dhe 32 të Kodit Penal, si dhe përcaktimet e neneve 13 e 75/a të Kodit të Procedurës Penale, konkludohet mbi kriteret e ligjit material dhe procedural penal përcaktues për dallimin ndërmjet krimit dhe kundërvajtjes penale, si dhe ndërmjet krimit të rëndë e atij jo të rëndë, e që kanë të bëjnë me llojin e marrëdhënies juridike që cenohet, llojin e dënimit, masën e dënimit, gjykatën kompetente nga pikëpamja lëndore dhe trupën gjykuese të caktuar nga ligji për gjykimin në themel, në varësi të llojit dhe të masës së dënimit.

Në rastin konkret, referuar dispozitës penale përkatëse, për të cilën Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme deklaron se janë akuzuar paditësit, neni 257/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal, referuar mënyrës, në të cilën pretendohet të jetë kryer vepra penale, nëpërmjet deklarimit të rremë, pa u pretenduar fshehja apo mosdeklarimi i pasurisë, referuar llojeve të dënimeve të parashikuara nga kjo dispozite penale, dënim me gjobë ose me burgim, referuar masës së dënimit me burgim, që parashikon kjo dispozitë, deri në tre vjet, si dhe duke theksuar faktin që, Prokurori, i cili është njeri prej subjekteve që kanë detyrimin për deklarim, në bazë të përcaktimeve të ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive”, është subjekt i figurës së kësaj vepre penale dhe jo subjekt i posaçëm i saj, e duke qenë se kjo vepër penale përfshihet në kompetencën lëndore të gjykimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, e që shqyrtohet në themel me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, rezulton se, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një krim të rëndë.

Neni 257/a i Kodit Penal, është një dispozite penale, e cila u shtua në Kodin Penal, si vepër penale, nëpërmjet ligjit me Nr. 9030, datë 13.03.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, me synimin për të siguruar mbrojtjen e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

marrëdhënieve juridike të vendosura për të garantuar deklarin e saktë të pasurisë prej subjekteve që kishin detyrimin për deklarim, pa dallim ndërmjet tyre, ku konsumimi i kësaj vepre penale nga ana e Prokurorit, as atëherë, e as tani, nuk përbën paragraf më vete të kësaj figure të veprës penale e as rrethanë cilësuese, e ku, qenia prokuror e personit, për të cilin pretendohet se ka kryer deklarim të rremë, as atëherë dhe as tani, nuk përbën subjekt të posaçëm të saj.

Për më tepër rezulton se, sipas ligjit me Nr. 9030, datë 13.03.2003 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë*", i cili e shtoi për herë të parë nenin 257/a në Kodin Penal, si një dispozitë penale, kjo figurë e veprës penale, në të katërta mënyrat e konsumimit të saj nga ana objektive, si me refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje dhe me deklarim të rremë, përbënte kundërvajtje penale dhe dënohej me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Ndryshimi i bërë kësaj dispozite penale me ligjin Nr. 9686, datë 26.02.2007, duke u rritur masa e dënimit me burgim vetëm me një vit, pra nga dy vjet që ishte më parë, në tre vjet sot, nuk e klasifikon figurën e veprës penale krim të rëndë.

Krimet e rënda, sipas përcaktimeve të neneve 1, 29, 31 dhe 32 të Kodit Penal si dhe përcaktimeve të neneve 13 e 75/a të Kodit të Procedurës Penale, janë ato të cilat ligjvënësi, në analizë të gjendjes së kriminalitetit dhe të politikës penale, i ka përfshirë në kompetencën lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda, apo të asaj kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe krimet e tjera, të cilat janë në kompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, por për të cilat Kodi Penal, parashikon vetëm dënimin me burgim, me një masë dënimi mbi 10 vjet burg.

2. Vepra penale që i atribuohet dy Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, *** dhe ***** , nuk mund të prezumohet se është kryer me dashje.**

Paditësit ***** dhe ***** , Prokurorë të Republikës së Shqipërisë prej 17 vjetësh, minimalisht kanë të drejtën e procesit të rregullt ligjor, që përfshin edhe fazën e hetimeve paraprake dhe të prezumimit të pafajësisë, derisa fajësia e tyre të vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prere.

Faji, si element i anës subjektive të figurës së veprës penale, mund të ekzistojë në formën e dashjes dhe të pakujdesisë dhe është element i të provuarit në procesin penal dhe i barrës së provës në proces të organit të akuzës, e nuk mund të prezumohet automatikisht për ato vepra penale, për të cilat ligjvënësi nuk e ka parashikuar shprehimisht në dispozitën penale përkatëse, kryerjen e tyre me dashje. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë janë parashikuar shprehimisht ato vepra penale, për të cilat ligji ka prezumuar kryerjen e tyre nga ana subjektive nëpërmjet dashjes si formë e fajit, ndërkohë që, vepra penale e parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë të Kodit Penal, nuk përfshihet në këtë kategori.

Për sa kohë që paditësit ende sot e kësaj dite nuk janë njoftuar asnjëherë nga ana e Prokurorëve të çështjes në Prokurorinë e Durrësit se ndaj tyre është regjistruar një procedim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

penal, se atyre i është regjistruar emri si persona, që i atribuohet vepra penale, se ata janë persona nën hetim e aq më tepër që ndaj tyre është ngritur një akuzë, në kushtet kur paditësit nuk janë në dijeni për faktet objekt akuzë e nuk janë pyetur mbi to, ndodhur përpara faktit që dispozita penale nuk parashikon kryerjen me dashje të veprës penale që i atribuohet atyre, nuk mund të prezumohet që, faji, si element i anës subjektive dhe kriteri i gjendjes së brendshme shpirtërore të personit, në momentin e konsumimit të veprës penale të pretenduar, të ketë ekzistuar në formën e dashjes.

3. Paditësit *** e ***** nuk rezultojn të kenë marrë cilësinë procedurale penale të pandehurit.**

Rezultojn se, pas nxjerrjes në datën 08.05.2018 të vendimit për marrjen e paditësve si të pandehur dhe njoftimin e akuzës dhe ende pa iu komunikuar atyre ky vendim, si dhe akti për njoftimin e akuzës, në datën 09.05.2018, Prokuroria e Durrësit shpalli moskompetencën e saj për zhvillimin e hetimeve në kuadër të këtij procedimi penal dhe vendosi kalimin e këtij procedimi penal Prokurorisë së Fierit.

Nga aktet e këtij procedimi penal të administruar me cilësinë provës në këtë gjykim administrativ rezultojn se:

a.-procedimi penal i paditësve në këtë gjykim, përfaqëson të vetmin rast në historinë e akuzës shqiptare, në të cilin është proceduar me marrjen e shtetasit në cilësinë e të pandehuri jo në përfundim të hetimeve, por pa u kryer hetim.

b.-Është proceduar me shpalljen e moskompetencës për të kryer hetim, pasi është nxjerrë vendimi për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin atij të akuzës dhe jo menjëherë pas përcjelljes së materialit hetimor, ndonëse ishte i qartë që në fillim shkaku që pengonte Prokurorinë e Durrësit për të vazhduar çdo lloj veprimi procedural penal me këtë material hetimor.

c.-Është proceduar me shpalljen e moskompetencës për të kryer hetim në një moment procedural penal që presupozon përfundimin e hetimeve, siç është marrja e personit si i pandehur dhe njoftimi atij të akuzës.

d.-Është proceduar me dërgimin e njoftimit me postë për akuzën nga Prokuroria e Durrësit, pasi kjo e fundit kishte shpallur moskompetencën e saj në lidhje me këtë procedim penal.

Nëpërmjet provave të paraqitura prej vetë palës së paditur u vërtetua në këtë gjykim në datën 14.05.2018, pra tre ditë pasi ishte vendosur pezullimi i paditësve nga detyra e prokurorit dhe pesë ditë pasi Prokuroria e Durrësit kishte shpallur mungesën e kompetencës tokësore të saj në lidhje me këtë procedimin penal të regjistruar ndaj tyre, kjo Prokurori i ka dërguar paditësve për njoftim nëpërmjet shërbimit postar, vendimin për shpalljen e moskompetencës, bashkëlidhur edhe dy aktet për njoftimin e akuzës. Nëpërmjet dëftësave të komunikimit përkatëse, të kthyera Prokurorisë së Durrësit në datën 18.05.2018, vërtetohet fakti se, i vetmi veprim procedural që është ndërmarrë nga Prokuroria Shqiptare për t'i komunikuar paditësve akuzën, është dërgimi atyre me postë, pas pezullimit nga detyra, i dy



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

vendimeve për marrjen si të pandehur, veprim procedural penal, i cili, për më tepër, është kryer nga ana e Prokurorisë jokompetente të Durrësit, që nëntë ditë më parë, pikërisht në datën 09.05.2018 kishte shpallur moskompetencën në lidhje me këtë procedim penal.

Ndërsa Prokuroria e Fierit, e cila ka vendosur pranimin e akteve të këtij procedimi penal, nuk ka kryer asnjë veprim procedural penal për të garantuar njoftimin e akuzës paditësve. Nëpërmjet provave të paraqitura nga ana e palës së paditur dhe të administruara në këtë gjykim vërtetohet se, njoftimet e kryera nga ana e Prokurorisë së Fierit, kanë patur për qëllim paraqitjen e paditësve pranë asaj Prokurorie për t'u pyetur dhe jo për njoftimin atyre të akuzës.

Vendimet Nr. 140 dhe 141, të Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme, Arta Marku, "Për pezullimin nga detyra të Prokurorëve ***** dhe *****", janë marrë në datën 11.05.2018, ndërkohë që, në këtë datë paditësit jo vetëm që nuk e kishin marrë cilësinë e të pandehurve, por ndaj tyre deri në këtë datë, Prokuroria e Durrësit ende nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për të garantuar komunikimin e aktit të njoftimit të akuzës.

Gjatë këtij hetimi gjyqësor u vërtetua plotësisht që Prokurorët ***** dhe ***** nuk e kishin marrë cilësinë e të pandehurit në kohën e pezullimit të tyre nga detyra prej Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme, pasi në datën 11.05.2018, të nxjerrjes së vendimeve të pezullimit të tyre nga detyra, atyre nuk iu ishin komunikuar aktet për njoftimin e akuzës.

Në bazë të përcaktimeve të neneve 34 dhe 34/a të K.Pr.Penale, si dhe Vendimeve Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 3, datë 27.09.2002 dhe Nr. 2, datë 20.06.2013, akti për njoftimin e akuzës, duhet t'i ishte komunikuar paditësve prej Prokurorisë së Durrësit, përpara se Prokuroria e Përgjithshme e Përkohshme të vendoste pezullimin e tyre nga detyra. Po sipas përcaktimeve të neneve 34 dhe 34/a të K.Pr.Penale dhe Vendimeve Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Nr. 3, datë 27.09.2002 dhe Nr. 2, datë 20.06.2013, akti për njoftimin e akuzës duhet t'i ishte njoftuar paditësve personalisht dhe në prani të mbrojtësve të tyre, prej Prokurorëve të çështjes ose Officerit të Policisë Gjyqësore të autorizuar prej tyre dhe jo nëpërmjet shërbimit postar, e aq më keq pas pezullimit të tyre, e akoma më keq nga ana e Prokurorisë jokompetente.

Në këtë gjykim është provuar se:

-Akti për njoftimin e akuzës nuk i ishte komunikuar paditësve në kohën e nxjerrjes së vendimit për marrjen e tyre si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, datë 08.05.2018.

-Akti për njoftimin e akuzës nuk i ishte komunikuar paditësve në kohën e pezullimit të tyre nga detyra, datë 11.05.2018.

-Akti për njoftimin e akuzës nuk i ishte komunikuar paditësve në kohën e nxjerrjes së vendimit të moskompetencës së Prokurorisë së Durrësit, datë 09.05.2018.

-Akti për njoftimin e akuzës nuk i ishte komunikuar paditësve as nëpërmjet njoftimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

postar të Prokurorisë së Durrësit, të datës 14.05.2018.

-Akti për njoftimin e akuzës nuk i ishte komunikuar deri më sot paditësve as nga Prokuroria e Fierit që ka pranuar zhvillimin e hetimeve në kuadër të këtij procedimi penal.

Nga sa më sipër, përsa i përket paligjshmërisë së akteve të kundërshtuara gjyqësisht prej palës paditëse analizojmë se:

i. Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme nuk mund të vendoste pezullimin nga detyra të Prokurorëve ***** dhe ***** , pa i'u komunikuar atyre më parë akti i njoftimit të akuzës, pasi, vetëm në atë moment mund të konsiderohet se personi merr cilësinë procedurale penale të të pandehurit në një procedim penal.

ii. Njoftimi i akuzës duhet t'i ishte bërë paditësve ***** dhe ***** , me akt të shkruar nga Prokurorët e çështjes ose nga Oficeri i Policisë Gjyqësore i autorizuar prej Prokurorëve të çështjes dhe jo nëpërmjet shërbimit postar.

iii. Njoftimi i akuzës duhet t' ishte bërë personalisht paditësve ***** dhe ***** dhe me pjesëmarrjen e detyrueshme të mbrojtësve të tyre, vetëm pasi Prokurorët e çështjes ose Oficeri i Policisë Gjyqësore i autorizuar, t'i bënte të ditur paditësve të drejtat e parashikuara në nenin 34/a pikat "a", "b", "c", "c", "d", "dh" dhe "e" të këtij neni dhe pas dorëzimit atyre, kundrejt nënshkrimit, të letrës të se drejtave të të pandehurit në formë të shkruar, e nuk mund t'i dërgohej paditësve për komunikim nëpërmjet shërbimit postar.

iv. Veprimet procedurale për njoftimin e akuzës paditësve nuk duhet të ishin ndërmarrë pas pezullimit të paditësve nga detyra, por më parë Prokurorët e çështjes duhet të kishin konfirmuar komunikimin paditësve të aktit për njoftimin e akuzës dhe vetëm pas kësaj, duhet t'i kishin dërguar njoftim Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme.

v. Veprimet procedurale për njoftimin e akuzës paditësve nuk mund të ndërmerreshin nga Prokuroria e Durrësit pesë ditë pasi ajo kishte shpallur moskompetencën e saj dhe ia kishte dërguar aktet e këtij procedimi penal Prokurorisë së Fierit.

vi. Akti për njoftimin e akuzës, që përfaqëson aktin procedural më të rëndësishëm gjatë hetimeve në kuadër të një procedimi penal, nuk mund t'i komunikohet të pandehurit nëpërmjet shërbimit postar, e aq më tepër si pjesë përbërëse e njoftimit të dërguar mbi vendimin e moskompetencës së Prokurorisë për të hetuar në kuadër të një procedimi penal, për të cilin këta shtetas u morën si të pandehur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

vii. Në interpretim të nenit 78 të K.Pr.Penale, vendimi i moskompetencës nuk mund të merrej nga ana e Prokurorisë së Durrësit pa iu komunikuar më parë paditësve akti i njoftimit të akuzës dhe pa marrë ata më parë cilësinë e të pandehurve.

Vetëm fakti i nxjerrjes prej Prokurorëve të çështjes të vendimit për marrjen e personit si të pandehur dhe për njoftimin atij të akuzës, nuk presupozon përmbushjen prej organit të akuzës të detyrimit kushtetues dhe ligjor për t'ia komunikuar realisht personit nën hetim aktin për njoftimin e akuzës. Momenti i nxjerrjes prej Prokurorëve të çështjes të vendimit për marrjen e personit si të pandehur dhe për njoftimin atij të akuzës, nuk presupozon dhe as nuk barazohet me momentin se kur personi nën hetim merr cilësinë e të pandehurit, pasi ky moment procedural penal, nuk lidhet me marrjen e vendimit prej organit të akuzës, por me komunikimin e këtij vendimi, pra të aktit të njoftimit të akuzës, personit ndaj të cilit është marrë, duke i bërë të ditur këtij personi, të dhënat e grumbulluara deri në atë fazë të hetimit paraprak, të cilat janë vlerësuar të mjaftueshme, për të konkluduar si për natyrën kriminale të veprës së kryer, ashtu dhe për autorin e saj dhe fajësinë e tij.

Komunikimi paditësve të vendimeve të Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme, për pezullimin e tyre nga detyra, nuk përfaqëson aktin për njoftimin paditësve të akuzës, sipas përcaktimeve të neneve 34 dhe 34/a të K.Pr.Penale, si dhe Vendimeve Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 3, datë 27.09.2002 dhe Nr. 2, datë 20.06.2013.

Dërgimi paditësve prej Prokurorisë së Fierit të njoftimeve për t'u paraqitur për pyetje, nuk presupozon që paditësve i është komunikuar akuzë dhe as nuk tregon apo vërteton që ata kanë marrë cilësinë e të pandehurve në këtë procedim penal. Paraqitja prej paditësve në Prokurorinë e Fierit, shumë kohë pas pezullimit tyre nga detyra, të memove apo kërkesave procedurale, nuk do të thotë që paditësve i është komunikuar akti për njoftimin e akuzës apo që ata kanë marrë cilësinë e të pandehurve.

Rënia në dijeni e paditësve prej medias, nga vendimet e pezullimit e pezullimit apo gjatë këtij gjykimi, rreth një procedimi penal të filluar ndaj tyre, nuk barazohet me komunikimin atyre të akteve për njoftimin e akuzës dhe as nuk mund të interpretohen si marrja prej paditësve të cilësisë procedurale penale të të pandehurve në këtë procedim penal, pa u respektuar procedurat ligjore të komunikimit prej organit të akuzës të aktit të njoftimit të akuzës, sipas përcaktimeve të neneve 34 dhe 34/a të K.Pr.Penale, si dhe Vendimeve Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 3, datë 27.09.2002 dhe Nr. 2, datë 20.06.2013.

Vetëm fakti i zhvillimit të hetimeve ndaj Prokurorit, apo i regjistrimit ndaj tij të një procedimi penal, nuk është shkak i mjaftueshëm për pezullimin nga detyra të Prokurorit. Kushtetuta dhe Ligji kërkojnë patjetër që Prokurori të ketë marrë cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë dhe të kryer me dashje, para se ndaj tij të merret masa administrative e pezullimit nga detyra.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Në rastin konkret rezulton se, Vendimet Nr. 140 dhe 141, datë 11.05.2018, për pezullimin nga detyra të Prokurorëve ***** dhe ***** , janë marrë prej Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme në kundërshtim me ligjin, pa marrë këta prokurorë cilësinë e të pandehurve për një krim të rëndë dhe të kryer me dashje.

Referuar analizës së mësipërme, në kushtet kur nuk rezulton që paditësit të kenë marrë cilësinë procedurale penale të pandehurve, vepra penale për të cilën pretendohet se janë akuzuar, nuk përbën krim të rëndë, si dhe dispozita penale përkatëse nuk parashikon kryerjen e kësaj vepre penale vetëm me dashje, nuk plotësohen kërkesat e parashikuara nga neni 148/d pika 4, germa "b" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 151 pika 1, germa "b" të ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" për pezullimin nga detyra të Prokurorëve ***** dhe *****.

III. Prapësimet e palës së paditur, Prokuroria e Përgjithshme:

Pala e paditur, Prokuroria e Përgjithshme, duke kërkuar rrëzimin e padisë, gjatë gjykimit dhe në pretendimet përfundimtare, ka prapësuar si vijon:

A. Sipas paditësve: "Prokurorët e Republikës së Shqipërisë *** dhe ***** nuk janë mbajtës të cilësisë së të pandehurit".**

Në lidhje me këtë pretendim dhe argumenteve të paraqitura nga paditësit sipas të cilëve ato shprehen se: "Marrjen e personit në cilësinë e të pandehurit, prokurori i çështjes është i detyruar t'a realizojë nëpërmjet njoftimit të akuzës me akt të shkruar", prapësojmë se:

Siç rezulton nga aktet, prova shkresore, fillimisht paditësit duke u njohur, marrë dijeni në lidhje me "Vendim për pezullimin nga detyra të prokurorit", të Prokurorit të Përgjithshëm, me datë 14.05.2018 paditësja ***** dhe me datë 15.05.2018, paditësi ***** , janë vënë në dijeni me përmbajtjen e këtyre vendimeve, respektivisht me numër 140, datë 11.05.2018, paditësja ***** dhe numër 141, datë 11.05.2018, paditësi ***** .

Nga përmbajtja e këtyre dy vendimeve, provohet dhe citohet qartë se këto vendime janë ekzekutuar, duke u pezulluar nga detyra të dy paditësit, me arsyetimin se nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Durrës, në datë 03.04.2018, është regjistruar procedimi penal nr. 577, në ngarkim të shtetasve ***** , me detyrë prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë, si dhe ***** , me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për veprën penale "Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", në formën e deklarimit të rremë, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Me datë 08.05.2018 nga prokurorët e çështjes është nxjerrë Vendimi “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” për prokuroren *****, duke e akuzuar për veprën penale të sipërcituar, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal si dhe po në datë 08.05.2018, nga prokurorët e çështjes është nxjerrë Vendimi “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” për prokurorin *****, duke e akuzuar për veprën penale të sipërcituar, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal.

Pra, që në momentin që nga prokurorët e çështjes, është marrë vendimi “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, datë 08.05.2018, për shtetasen ***** si dhe po në të njëjtën datë për shtetasin ***** , në të cilat vendime janë arsyetuar dhe argumentuar shkaqet dhe provat që janë grumbulluar në lidhje me çështjen penale të regjistruar me numër 577, datë 03.04.2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a-2 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve ***** dhe ***** , paditësit ***** dhe ***** , e kanë marrë cilësinë e të pandehurit, konform nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit parashikohet se: *“Merr cilësinë e të pandehurit, personi të cilit i atribuohet vepra penale, me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.”*

Në zbatim të urdhërimit të gjykatës për paraqitjen e të gjitha akteve që kanë të bëjnë me njoftimin e vendimeve për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës, me shkresën Nr. 2036/7 prot., datë 02.10.2018 “Kërkesë për informacion” i jemi drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për të na informuar në mënyrë të hollësishme në lidhje me procedurën e ndjekur nga ana e prokurorisë për njoftimin e akuzës të pandehurve ***** dhe ***** , si dhe dokumentet provë shkrese në lidhje me këtë procedurë.

Me shkresën Nr. 10551/1 prot., datë 08.10.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, ka dërguar informacionin së bashku me aktet shoqëruese, që provojnë procedurën e ndjekur nga kjo prokurori, deri në këtë fazë të hetimeve. Sa më sipër i kemi paraqitur gjykatës, së bashku me provat përkatëse kronologjinë e veprimeve të kryera nga organi i akuzës për njoftimin e dy të pandehurve, paditësve ***** dhe ***** , si më poshtë:

Me “Urdhër për regjistrimin e procedimit penal dhe regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, datë 03.04.2018, të prokurorit të çështjes, është urdhëruar: “Regjistrimi i procedimit penal nr. 577, për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal.

Në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse, për procedimin penal nr. 577, të vitit 2018, të shënohet emri i personit nën hetim:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

a.-*****, dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal.

b.-*****, dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal....”.

Me “Vendim për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, datë 08.05.2018, të prokurorëve të çështjes, është marrë si e pandehur shtetasja ***** për veprën penale të “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal.

Me “Vendim për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, datë 08.05.2018, të prokurorëve të çështjes, është marrë si i pandehur shtetasi ***** për veprën penale të “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal.

Me “Vendim për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve”, datë 09.05.2018, prokurorët kanë vendosur:

- “1. Shpalljen e moskompetencës për procedimin penal Nr. 577, të vitit 2018.
2. Dërgimin e akteve Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”.

Me shkresën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, nr. 1636 prot., datë 14.05.2018, drejtuar shtetasve ***** dhe ***** , ju është dërguar për njoftim, bashkëlidhur saj nëpërmjet “Dëftesë komunikimi”, “Vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve të procedimit penal nr. 577, të vitit 2018, së bashku me dy aktet për njoftimin e akuzës dhe marrjen me cilësinë e të pandehurit”, në rrugë postare. Nga ana e postës, është vënë shënimi “Marrësi nuk ndodhen në banesë”.

Me “Vendim për pranimin e akteve dhe regjistrimin e procedimit penal” të prokurorit, D.T, datë 16.05.2018, është vendosur për: “Pranimin e akteve të procedimit penal nr. 577, të vitit 2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dherregjistrimin e procedimit penal nr. 737, të vitit 2018....”.

Me shkresën nr. 5681 prot., datë 21.05.2018 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar shtetasit ***** , bashkëlidhur saj i është dërguar njoftimi për t’u paraqitur në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Ky njoftim është bërë nëpërmjet shërbimit postar, siç vërtetohet edhe nga zarfi, bashkëlidhur, në të cilin është vënë shënimi “Kthehet, objekt i pakërkuar”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Me shkresën nr. 5681/1 prot, datë 21.05.2018 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar shtetases ***** , bashkëlidhur saj i është dërguar njoftimi për t'u paraqitur në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Sipas shkresës "Njoftim për paraqitje", ky njoftim është bërë nëpërmjet shërbimit postar, siç vërtetohet edhe nga zarfi, bashkëlidhur,në të cilin është vënë shënimi "Kthehet, objekt i pakërkuar".

Me shkresën nr. 5948 prot., datë 25.05.2018 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar shtetases ***** , bashkëlidhur saj i është dërguar njoftimi për t'u paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Sipas shkresës "Njoftim për paraqitje", ky njoftim do të bëhej nga oficeri i policisë gjyqësore dhe është bërë nëpërmjet shërbimit postar. Në zarfin bashkëlidhur është vënë shënimi "Kthehet, objekt i pakërkuar".

Me shkresën nr. 5948/1 prot., datë 25.05.2018 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar shtetasit ***** , bashkëlidhur saj i është dërguar njoftimi për t'u paraqitur në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Sipas shkresës "Njoftim për paraqitje", ky njoftim do të bëhej nga oficeri i policisë gjyqësore dhe është bërë nëpërmjet shërbimit postar. Në zarfin bashkëlidhur është vënë shënimi "Kthehet, objekt i pakërkuar".

Sipas "Proces-verbal për njoftimin e shtetasit nëpërmjet telefonit", datë 31.05.2018, ora 12.30, të oficerit të policisë gjyqësore F.M, pasi nuk është bërë i mundur njoftimi me shërbimin postar, është bërë thirrja telefonike në numrin zyrtar të përdoruesit ***** , me qëllim njoftimi për t'u paraqitur tek prokurori i çështjes D.T. pasi ai nuk është përgjigjur dy thirrjeve, nga ana e opgj-së i është dërguar edhe sms, për të cilin përsëri nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Me shkresën nr .6932 prot., datë 19.06.2018 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar shtetasit ***** , bashkëlidhur saj i është dërguar njoftimi për t'u paraqitur në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Sipas shkresës "Njoftim për paraqitje", ky njoftim do të bëhej nga oficeri i policisë gjyqësore dhe është bërë nëpërmjet shërbimit postar, dhe në zarfin bashkëlidhur është vënë shënimi "Kthehet, objekt i pakërkuar".

Me shkresën nr. 6932/1 prot, datë 19.06.2018 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar shtetases ***** , bashkëlidhur saj i është dërguar njoftimi për t'u paraqitur në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Sipas shkresës "Njoftim për paraqitje", ky njoftim do të bëhej nga oficeri i policisë gjyqësore dhe është bërë nëpërmjet shërbimit postar, dhe në zarfin bashkëlidhur është vënë shënimi "Kthehet, objekt i pakërkuar".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Sipas "Proces-verbal për njoftimin e shtetasit nëpërmjet telefonit", datë 28.06.2018, ora 15.00, të oficerit të policisë gjyqësore F.M, duke respektuar kërkesat e Nenit 133 e vijues dhe 303/2 të Kodit të Procedurës Penale, për të dokumentuar njoftimin nëpërmjet telefonit të shtetasit ***** për hetimin e procedimit penal Nr. 737, vitit 2018, pasi nuk është bërë i mundur njoftimi me shërbimin postar, është bërë thirrja telefonike (gjithsej 3 herë), në numrin zyrtar të përdoruesit ***** , me qëllim njoftimi për t'u paraqitur tek prokurori i çështjes D.T. por ai nuk është përgjigjur thirrjeve, të OPGJ-së.

Me shkresën nr. 7528 prot., datë 04.07.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar Komisarariatit Nr. 1, të Policisë Tiranë, është kërkuar "Njoftimi i shtetasës *****" për t'u paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nëpërmjet njoftimit bashkëlidhur dhe ky njoftim do të bëhej nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore të Komisarariatit Nr. 1, Tiranë.

Me shkresën nr. 7528/1 prot., datë 04.07.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar Komisarariatit Nr. 1, të Policisë Tiranë, është kërkuar "Njoftimi i shtetasit *****" për t'u paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nëpërmjet njoftimit bashkëlidhur dhe ky njoftim do të bëhej nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore të Komisarariatit Nr. 1, Tiranë.

Me shkresën Nr. 5125/1 prot., datë 12.07.2018, Komisarhati i Policisë Nr. 1, Tiranë, i është drejtuar Komisarariatit të Policisë Nr. 4, Tiranë, dhe për dijëni Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për të bërë të mundur njoftimin e shtetasit *****.

Po kështu me shkresën Nr. 5126/1 prot., datë 12.07.2018, Komisarhati i Policisë Nr. 1, Tiranë, i është drejtuar Komisarariatit të Policisë Nr. 4, Tiranë, dhe për dijëni Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për të bërë të mundur njoftimin e shtetasës *****.

Me shkresën nr. 4642/1 prot., datë 02.08.2018 Komisarhati i Policisë Nr. 4, Tiranë, i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, duke e vënë në dijëni në lidhje me verifikimet e kryera nga ky komisarhat, për njoftimin e shtetasës *****.

Me shkresën nr. 4645/1 prot., datë 02.08.2018 Komisarhati i Policisë Nr. 4, Tiranë, i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, duke e vënë në dijëni në lidhje me verifikimet e kryera nga ky komisarhat, për njoftimin e shtetasit *****.

Me shkresën nr. 8133 prot., datë 18.07.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar Komisarariatit Nr. 1 të Policisë Tiranë, është kërkuar "Njoftimi i shtetasit *****" për t'u paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nëpërmjet njoftimit bashkëlidhur dhe ky njoftim do të bëhej nëpërmjet oficerit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

policisë gjyqësore të Komisarariatit Nr. 1, Tiranë.

Me shkresën nr. 8133/1 prot., datë 18.07.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar Komisarariatit Nr. 1, të Policisë Tiranë, është kërkuar “Njoftimi i shtetasës *****” për t’u paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nëpërmjet njoftimit bashkëlidhur dhe ky njoftim do të bëhej nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore të Komisarariatit Nr. 1, Tiranë.

Me shkresën nr. 5502/1 prot, datë 01.08.2018, Komisarati i Policisë Nr. 1, Tiranë, i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe për dijeni Komisarariatit të Policisë nr. 4, Tiranë, duke e vënë në dijeni në lidhje me verifikimet e kryera nga ky komisarati, në lidhje me njoftimin e shtetasit *****.

Me shkresën nr. 5503/1 prot, datë 01.08.2018, Komisarati i Policisë Nr. 1, Tiranë, i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe për dijeni Komisarariatit të Policisë nr. 4, Tiranë, duke e vënë në dijeni në lidhje me verifikimet e kryera nga ky komisarati, në lidhje me njoftimin e shtetasës *****.

Me shkresën 5142/1 prot., datë 09.08.2018, Komisarati i Policisë Nr. 4, Tiranë, i ka kthyer përgjigje Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, duke e vënë në dijeni në lidhje me verifikimet e kryera për njoftimin e shtetasit *****.

Me shkresën 5143/1 prot., datë 09.08.2018, Komisarati i Policisë Nr. 4, Tiranë, i ka kthyer përgjigje Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, duke e vënë në dijeni në lidhje me verifikimet e kryera për njoftimin e shtetasës *****.

Me shkresën nr. 8215 prot., datë 20.07.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar Komisarariatit Nr. 4, të Policisë Tiranë, është kërkuar “Njoftimi i shtetasit *****” për t’u paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nëpërmjet njoftimit bashkëlidhur dhe ky njoftim do të bëhej nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore të Komisarariatit Nr. 4, Tiranë.

Me shkresën nr. 8215/1 prot., datë 20.07.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuar Komisarariatit Nr. 4, të Policisë Tiranë, është kërkuar “Njoftimi i shtetasës *****” për t’u paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nëpërmjet njoftimit bashkëlidhur dhe ky njoftim do të bëhej nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore të Komisarariatit Nr. 4, Tiranë.

Me shkresën 4908/1 prot., datë 02.08.2018, Komisarati i Policisë Nr.4 Tiranë, i ka kthyer



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

përgjigje Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, duke e vënë në dijeni në lidhje me verifikimet e kryera për njoftimin e shtetasit *****.

Me shkresën 4909/1 prot., datë 02.08.2018, Komisariati i Policisë Nr. 4, Tiranë, i ka kthyer përgjigje Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, duke e vënë në dijeni në lidhje me verifikimet e kryera për njoftimin e shtetasës *****.

Pra siç vërehet, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe ajo e Fierit, është ndjekur përpikërisht procedura për njoftimin e të pandehurve të lirë, janë përdorur të gjitha format e njoftimit të paditësve ***** dhe ***** në lidhje me komunikimin e këtyre akteve, vendimeve dhe pyetjen e tyre në lidhje me faktin penal në ngarkim të tyre, sipas shkresave të sipërcituara. Por, pavarësisht pretendimeve të tyre, në informacionin e dërguar pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ndër të tjera prokurori i çështjes shprehet se:

*“Nga ana tjetër të pandehurit ***** dhe ***** kanë paraqitur dy memorie njëra me datë 27.07.2018 dhe datë 13.09.2018 me objekt disa kërkesa procedurale lidhur me këtë procedim penal duke shprehur dijeninë e tyre rreth akuzës. Memoriet janë paraqitur në sekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Në vijim të hetimeve nga ana e kësaj prokurorie është proceduar me hetimet paraprake pa praninë e të pandehurve”.*

Vetë paditësit në këtë padi shprehen se: “Akti për njoftimin e akuzës, ... në përputhje me përcaktimet e neneve 34 pika 1, 134 dhe 140 të Kodit të Procedurës Penale, duhet t'i njoftohet personit, për të cilin është vendosur marrja si i pandehur dhe mbrojtësit të tij, nëpërmjet Policisë Gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar, në banesën e tij apo në vendin e punës...”.

Kodi i Procedurës Penale, ka parashikuar format, mënyrat dhe mjetet e njoftimit në kreun II-të Njoftimet, deri tek parashikimet e Nenit 140 “Njoftimi për herë të parë i të pandehurit të lirë”, ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”.

Së pari, në lidhje me regjistrimin e procedimit penal dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale është një e drejtë ekskluzive e prokurorit, i cili pasi kryen hetime të plota dhe të gjithanshme, në momentin që konkludon se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova lidhur me faktin penal për të cilin dyshohen të hetuarit, vendos përpilimin e aktit të njoftimit të akuzës. Ky akt rezultoi se është përpiluar me datën 08.05.2018 për të dy të pandehurit, paditësit ***** dhe ***** dhe nuk mund të diskutohet.

Së dyti, kemi të bëjmë me pyetjen në cilësinë e të pandehurit, ku njoftimet do të vijojnë sipas nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale dhe nëse i pandehuri i fshihet hetimeve për çfarëdo shkak, procedura ka parashikuar dhe vijimin e veprimeve në mungesë, procedurë e cila ka vijuar tashmë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Paditësit në padinë e tyre i referohen edhe dy Vendimeve Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe pikërisht Vendimit Nr. 3, datë 27.09.2002 dhe Vendimit Nr. 2, datë 20.06.2013, por pa iu futur analizës që bëhet në këto dy vendime unifikuese, konstatojmë dhe vlerësojmë se në rastin objekt gjykimi, ato nuk janë referencë e duhur ligjore sepse kanë të bëjnë me masat e sigurimit personal, sipas të cilit në Vendimin Nr. 3, datë 27.09.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është arritur në përfundimin se: *“Si përfundim Kolegjet e Bashkuara theksojnë se masat e sigurimit mund të caktohen edhe pa u marrë personi më parë si i pandehur, me kusht që të jetë vënë në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet dhe për të drejtat e tij (neni 31 i Kushtetutës).”*

Ndërsa Vendimi Nr. 2, datë 20.06.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, fillimisht trajton konceptin e subjekteve të procedimit penal si dhe më pas analizon dhe unifikon praktikën në lidhje me kundërshtimin e vendimeve të mosfillimit të procedimit penal dhe pushimit të procedimit penal.

Në mënyrë të gabuar paditësit pretendojnë se: *“Sipas përcaktimeve të nenit 148/d pika 4 germa “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe përcaktimeve të nenit 151 pika 1, germa “b” të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Prokurori i kësaj Republike, nuk mund të pezullohet nga detyra, në qoftë se ai nuk e ka marrë cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë dhe të kryer me dashje.”*

Siç rezulton nga aktet prova shkresore të Vendimeve “Për pezullimin nga detyra të prokurorit”, Nr. 140 dhe 141, datë 11.05.2018, nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, bazuar në nenet 148/d pika 4, germa “b” dhe 179 pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 151, pika 1, germa “b” dhe pika 2 germa “b”; 155 dhe 160 pika 2, germa “c” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është vendosur pezullimi i dy prokurorëve, paditësve ***** dhe *****.

Dhe në këto vendime përveç të tjerave është arsyetuar edhe fakti se Prokurori i Përgjithshëm, ka vendosur pezullimin e këtyre dy prokurorëve si persona për të cilët ka filluar procedimi penal nr. 577/2018 dhe ndaj të cilëve nga prokurorët përkatës është marrë “Vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, datë 08.05.2018, duke u akuzuar për kryerjen e veprës penale, “Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, në formën e deklarimit të rremë, parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal.

Pra rezulton qartë dhe krejtësisht ligjore procedura e ndjekur nga Prokurori i Përgjithshëm, sipas kompetencave ligjore që ka, në nxjerrjen e këtyre dy akteve objekt



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

gjykimi, Vendimeve nr. 140, dhe 141, datë 11.05.2018. Në mbështetje të Kushtetutës si dhe dispozitave të tjera ligjore, pas marrjes dijeni për regjistrimin e procedimit penal nr. 577, datë 03.04.2018, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në ngarkim të shtetasve ***** dhe ***** , për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a-2 të Kodit Penal, pas vendimit të nxjerrë nga prokurorët e çështjes me datë 08.05.2018 “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës për prokuroren ***** dhe prokurorin *****”, ka vendosur edhe pezullimin nga detyra të këtyre prokurorëve.

B. Sipas paditësve pretendohet se:”Vepra penale që i atribuohet dy prokurorëve të Republikës së Shqipërisë *** dhe ***** , nuk është një krim i rëndë”.**

Duke vazhduar arsyetimin e tyre “...se ato nuk janë njoftuar asnjëherë nga ana e prokurorëve të çështjes se ndaj tyre është depozituar një kallëzim penal, se në emër të tyre është regjistruar një procedim penal, se ndaj tyre janë zhvilluar hetime në kuadër të një procedimi penal të regjistruar në emër të tyre, e aq më keq akoma se në ngarkim të tyre është nxjerrë një vendim për marrjen në cilësinë e të pandehurve, pa iu njoftuar asnjë akuzë.”

Ndër të tjera vetë ato në kërkesëpadinë e tyre shprehen se: “Nga përmbajtja e Vendimeve me Nr. 140 dhe Nr. 141, datë 11.05.2018 të Prokurorës së Përgjithshme të Përkohshme rezulton se, me vendimin e datës 08.05.2018, prokurorët e çështjes në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës kanë vendosur marrjen si të pandehur të Prokurorëve ***** dhe ***** , për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë, në formën e deklarimit të rremë...”.

Pra, ndryshe nga sa pretendojnë, vetë paditësit duke u njohur me vendimin e pezullimit të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas të cilit rezulton edhe “Dëftesë komunikimi” e datës 14.05.2018 për prokuroren ***** dhe datë 15.05.2018 për prokurorin ***** , detyrimisht ato kanë marrë dijeni jo vetëm për fillimin e procedimit penal ndaj tyre, por edhe për vendimet për marrjen si të pandehur ndaj tyre.

Ndryshe nga sa pretendojnë paditësit se vepra penale e parashikuar nga neni 257/a-2 e Kodit Penal, nuk përbën një krim të rëndë, theksojmë përpara kësaj gjykate e cila ka si objekt gjykimi aktet administrative dhe konkretisht Vendimet për pezullim nga detyra të prokurorit, me të drejtë Prokurori i Përgjithshëm në vendimet përkatëse, ndër të tjera është shprehur se: “Vepra penale e parashikuar nga neni 257/a-2 e Kodit Penal, është krim i rëndë, i kryer me dashje për shkak të rëndësisë së posaçme të marrëdhënies juridike që cenohet, si dhe subjektit të veprës penale”.

Nga përmbajtja e dispozitës së nenit 257/a konstatohet se, vepra e kryer sipas paragrafit të parë përbën kundërvajtje penale, ndërsa sipas paragrafit të dytë, sipas të cilit akuzohen edhe paditësit, kryerja e kësaj vepre penale, përbën krim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Duhet theksuar fakti se paditësit janë marrë të pandehur dhe akuzohen se kanë kryer një krim siç është ai i parashikuar nga neni 257/a-2 i Kodit Penal, ndërkohë që kanë qenë me detyrë prokuror dhe për shkak të saj ato paraqesin një rrezikshmëri më të lartë, si persona që kanë pasur për detyrë në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, ushtrimin nga ana e tyre të ndjekjes penale dhe përfaqësimit e akuzës në gjyq si dhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Gjithashtu për shkak të kësaj detyre dhe rrethanave të kryerjes së kësaj vepre penale, paditësit detyrimisht si subjekt i posaçëm i kësaj vepre penale e bëjnë këtë vepër aq më shumë një krim të rëndë.

Sa i përket kësaj dispozite, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të siguruar saktësinë e burimeve të pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Cenimi i kësaj marrëdhënieje nga shtetasit, pavarësisht nga shkaqet, përbën vepër penale dhe passjell përgjegjësi penale.

Synimi kryesor i ligjvënësit në hartimin e këtij ligji, ka qenë që t'i japë prioritet të drejtës së informimit, (pra interesit të përgjithshëm publik), ndaj interesave private, të shprehura në këtë rast, në formën e deklaramit dhe publikimit të mundshëm të të dhënave personale mbi të ardhurat dhe pasurinë e subjekteve deklaruese, në funksion të transparencës dhe kontrollit, si një e drejtë në vetvete dhe në proporcion me synimin.

Vlen të theksojmë qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues Nr. 3, datë 02.11.2015, ku ndër të tjera citojmë:

“48. Rrethanat cilësuese, ndryshe nga rrethanat rënduese dhe lehtësuese, janë pjesë përbërëse e domosdoshme e veprës penale që e përcaktojnë atë ose shërbejnë për cilësimin ligjor të saj, duke e specifikuar veprën. Pra, janë ato elemente që janë parashikuar nga ligjvënësi në ndërtimin e vetë normës që parashikon veprën penale. Rrethanat cilësuese kanë të bëjnë me të dhënat e sjelljes kriminale, pra me veprimin a mosveprimin, me pasojën, por që nuk rrjedhin nga sjellja kriminale. Disa rrethana cilësuese, kanë të bëjnë me përcaktimin e subjektit të veprës penale; pra, përshkruajnë ose subjektin aktiv (autorin) ose atë pasiv të veprës penale. Në të drejtën penale, për disa vepra të caktuara penale, disa rrethana mund të përcaktojnë një subjekt të caktuar që mund të kryejë veprën penale; pra, një subjekt të posaçëm që mban disa cilësi të veçanta. Në këtë rast, kemi të bëjmë me vepra penale të veçanta, domethënë vepra penale që kryhen nga subjekte specifike (delicta propria), ndërsa për disa vepra të tjera penale, nuk ka ndonjë përcaktim të cilësisë së subjektit që kryen veprën penale dhe parashikohet ose kuptohet se “kushdo” mund të kryejë një vepër penale të caktuar. Në këtë rast, kemi të bëjmë me vepra penale të përgjithshme (delicta impropria), domethënë, vepra penale që kryhen nga subjekte të çfarëdoshme, ku cilësimi i subjektit aktiv nuk ka të bëjë me cilësimin e veprës penale.”.

C. Sipas paditësve:”Vepra penale që i atribuohet dy Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, *** dhe ***** , nuk mund të prezumohet se është kryer me dashje”.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Nga ana subjektive, vepra penale e deklarimit të rremë të pasurisë kërkon një formë konkrete faji, me dashje dhe në shumicën e rasteve shoqërohet nga motivet që e kanë shtyrë atë të kryejë veprën penale. Pavarësisht qëllimit dhe motiveve që i kanë shtyrë paditësit për të kryer deklaram të rremë, është e mjaftueshme vetëm ekzistenca e pasurive të subjektit, të ndryshme nga ato të deklaruara, të lëna jashtë këtyre deklarimeve periodike për të pranuar konsumimin e plotë të kësaj vepre penale.

Duke u nisur nga fakti se paditësit ***** dhe *****, janë marrë të pandehur dhe akuzohen për kryerjen e një krimi, detyrimisht që dashja si element i anës subjektive ekziston dhe ka të bëjë me kryerjen e krimin, që lidhet me hetimet e kryera në këtë procedim dhe që kanë të bëjnë me provat e grumbulluara nga ana e prokurorëve të çështjes. Si e tillë, derisa ato janë marrë të pandehur dhe janë akuzuar edhe dashja ekziston.

IV. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Gjykata e Apelit, në analizë të pretendimeve të paditësve, prapësimeve të palës së paditur, të provave shkresore të verifikuara në gjykim dhe normave ligjore relevante, vlerëson se, aktet administrative të nxjerra nga Prokuroria e Përgjithshme nuk gjejnë mbështetje në ligj, ndaj vendimet Nr. 140, datë 11.05.2018 dhe Nr. 141, datë 11.05.2018, të Prokurorës së Përgjithshme, për pezullimin nga detyra të prokurorëve ***** e *****, duhen shfuqizuar, në vështrim të nenit 40, pika 1, germa “a” të ligjit Nr. 49/2012, për arsytet e mëposhtme.

Gjykata e Apelit vëren se, Urdhrat nr. 140 dhe nr. 141, datë 11.05.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm për pezullimet nga detyra të prokurorës ***** dhe prokurorit *****, janë marrë bazuar në kompetencat transitore të tij, të përcaktuara në nenin 160 “*Organet kompetente për periudhën kalimtare*” të ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*” (të ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, 10.04.2017), i cili në pikën 2 të tij parashikon:

“2. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, **Prokurori i Përgjithshëm** do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj:

(...)

c) pezullon prokurorët, sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligj.”

Prokurori i Përgjithshëm në marrjen e urdhrave nr. 140 dhe nr. 141, datë 11.05.2018, referon në nenin 151 “*Pezullimi i detyruar*” të ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i cili parashikon:

“1. Magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit përkatës kur:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

...

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje.

2. Pezullimi, sipas pikës 1 të këtij neni, zgjat:

a) gjatë periudhës së arrestit në burg ose arrestit në shtëpi, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni;

b) deri në pushimin e çështjes penale ose në dhënien e një vendimi të formës së prerë, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja "b" të këtij neni."

Ky kolegji konstaton se, rregullimi që bën neni 151 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", buron nga përcaktimi kushtetues i nenit 148/d, pika 4, germa "b" e Kushtetutës që parashikon:

"1. Prokurori mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

2. Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur:

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës;

b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Kundër vendimit të shkarkimit bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.

4. Prokurori pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;

c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit."

Në vështrim të dispozitave të mësipërme arrihet në konkluzionin se, Prokurori i Përgjithshëm ka urdhëruar pezullimin nga detyra të paditësve ***** e ***** , në zbatim të pezullimit të detyruar, të parashikuar nga neni 148/4, germa "b" e Kushtetutës, si edhe neni 151/1, germa "b" e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 105 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përcakton llojet e masave disiplinore, të cilat aplikohen nga këshillat gjyqësor dhe i prokurorisë, në përfundim të një procedimi disiplinor.

Sipas këtij parashikimi, ato janë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

a) vërejtje konfidenciale;

b) vërejtje publike;

c) ulje e përkohshme e pagës;

ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër;

d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;

dh) shkarkim nga detyra.

Ndërkohë, neni 110 "Pezullimi si masë disiplinore" i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", detajon rastet e pezullimit nga detyra si masë disiplinore, duke parashikuar:

"Masa e pezullimit nga detyra e magjistratit, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, jepet vetëm në këto raste:

a) kur shkelja është e shumë e rëndë;

b) kur Këshilli çmon se, pavarësisht se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes nuk e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin, rëndësia e shkeljes dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të magjistratit kërkojnë që magjistrati të pezullohet për një kohë të caktuar".

Gjykata e Apelit, në analizë të dy instituteve të pezullimit që parashikon ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", konkludon se, Këshillat

mund të vendosin pezullimin nga detyra të një magjistrati në dy raste:

- ✓ kur pezullimi vendoset si masë disiplinore në përfundim të një procedimi disiplinor të nisur në zbatim të neneve 105 e 110 të ligjit nr. 96/2016; dhe
- ✓ Kur aplikohet pezullimi i detyruar, që jepet për shkak dhe në funksion të një procedimi penal.

Në vlerësimin e këtij kolegji, në rastin *de quo*, pezullimi i vendosur ndaj prokurorëve ***** e ***** është bërë si një masë e përkohshme që vendoset ndaj magjistratit, deri në përfundimin e çështjes penale, për shkak të zbatimit të nenit 151 të ligjit nr. 96/2016.

Në gjykim nuk u provua që ndaj paditësve të ketë nisur ndonjë procedim disiplinor që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

mund të përfundohej si procedurë me dhënien e masës disiplinore të pezullimit nga detyra sipas neneve 105 e 110 të ligjit nr. 96/2016. Pezullimi nga detyra i prokurorëve ***** dhe ***** rezulton të jetë urdhëruar prej Prokurorit të Përgjithshëm, në zbatim të institutit të pezullimit të detyruar të lidhur ekskluzivisht me procesin penal që ka nisur në ngarkim të tyre.

Në lidhje me gjykatën kompetente për shqyrtimin e vendimeve të Prokurorit të Përgjithshëm për pezullimin e detyruar, në funksion të procedimit penal të filluar ndaj prokurorit, Kolegji i Posaçëm i Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, ka arritur në përfundimin se:

“Kolegji çmon se urdhrat e nxjerrë për pezullimin e detyruar të prokurorëve, janë akte administrative individuale në kuptim të neneve të mësipërme të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Duke iu rikthyer parashikimit të nenit 192/1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Kolegji çmon se me gjykatë kompetente për shqyrtimin e ankimit ndaj këtyre akteve individuale, duhet të kuptohet Gjykata e Apelit Administrativ, në të cilën ankimohen vendimet e këshillave që janë akte administrative për shkak të pasojave që prodhojnë për magistratët, akte që nuk janë masa disiplinore. Në këtë kategori, në vlerësimin e Kolegjit, duhet të përfshihet edhe akti i pezullimit nga detyra si një pezullim i detyruar, objekt ankimi, i nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm.”

Paditësit kanë pretenduar paligjshmërinë e akteve administrative individuale të nxjerrë nga pala e paditur, Prokuroria e Përgjithshme, në kuptim të nenit 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ” të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili ka këtë përmbajtje:

“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;
- d) **është në kundërshtim me ligjin material;**
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo
- e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.”

Në identifikim të shkakut juridik të padisë, ky kolegji arrin në konkluzionin se paditësit kërkojnë deklarimin e paligjshmërisë së akteve administrative, vendimeve nr. 140 e nr. 141, datë 11.05.2018, të palës së paditur, Prokuroria e Përgjithshme, si akte të marrë në kundërshtim me ligjin material, nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Gjykata e Apelit evidenton se, paditësit kanë ngritur tre pretendimeve themelore për paligjshmërinë e akteve administrative me të cilat janë pezulluar nga detyra, në funksion të procedimit penal të filluar ndaj tyre:

- faktin se vepra penale që iu atribuohet nuk përbën krim të rëndë;
- vepra penale që iu atribuohet nuk kryhet vetëm me dashje; dhe
- ata nuk kanë marrë cilësinë e të pandehurit, në përputhje me normat ligjore.

Ky kolegji vëren se, neni 257/a i Kodit Penal ka këtë përmbajtje:

“Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.

Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të persona vetë zgjedhur dhe nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”

Neni 257/a i Kodit Penal u shtua në Kodin Penal, si vepër penale, nëpërmjet ligjit me Nr. 9030, datë 13.03.2003 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”*. Qëllimi i këtij parashikimi ishte nevoja për të siguruar mbrojtjen e marrëdhënieve juridike të vendosura për të garantuar deklarimin e saktë të pasurisë prej subjekteve që kishin detyrimin për deklarim. Kjo figurë e veprës penale, në të katërt mënyrat e konsumimit të saj nga ana objektive, si me refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje dhe me deklarim të rremë, fillimisht përbënte kundërvajtje penale dhe dënohej me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Ndryshimi i bërë kësaj dispozite penale me ligjin Nr. 9686, datë 26.02.2007, e shndërroi këtë figurë në krim, duke e rritur masën e dënimit me burgim me një vit.

Në gjykim është provuar që palët ndërgjyqëse mbajnë qëndrime të kundërta në lidhje me cilësimin si “të rëndë” të krimit të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 257/a të Kodit Penal. Ndërsa pala paditëse, ka pretenduar se krimi që iu atribuohet atyre nuk është “krim i rëndë”, pala e paditur, ka prapësuar se, vepra penale e parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal, përbën krim të rëndë të kryer me dashje, për shkak të rëndësisë së posaçme të marrëdhënies juridike që cenohet, si dhe subjektit të veprës penale.

Gjykata e Apelit, në dallim me sa ka prapësuar pala e paditur, vlerëson se krimi i parashikuar në nenin 257/a-2 të Kodit Penal, nuk përbënë krim të rëndë. Për të arritur në këtë konkluzion ky kolegji pati parasysh, llojin e veprës penale që akuzohen paditësit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Neni 1 “*Ligji penal dhe ndarja e veprave penale*” i ligjit Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim referuar si “Kodi Penal”), përcakton:

“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre.

Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi.”

Ndërsa neni 29(1) i Kodit Penal “*Dënimet kryesore*” ka këtë përmbajtje:

“Për personat që kanë kryer krime jepen këto dënime kryesore:

- 1. Me burgim të përjetshëm*
- 2. Me burgim*
- 3. Me gjobë.”*

Ndërkaq neni 32(1) i të njëjtit kod lexon:

“Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet.”

Ndërsa ligji Nr. 7905, datë 21.3.1995 “*Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë*” (në vijim referuar si “K.Pr.Penale”), në nenin 13 të tij parashikon:

“1. Veprat penale gjykohen në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, sipas rregullave dhe përgjegjësive të caktuara në këtë Kod.

2. Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar gjykojnë me një gjyqtar:

- a) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake;*
- b) ankimi ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e ndjekjes penale apo pushimin e çështjes për kundërvajtjet penale;*
- c) kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes për krimet;*
- ç) kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq;*
- d) kërkesën e prokurorit për miratimin e urdhrit penal;*
- dh) kërkesat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale;*
- e) kërkesat për rivendosje në afat;*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

ë) kërkesat që lidhen me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, sipas titullit X të këtij Kodi;

f) çdo kërkesë tjetër të parashikuar në këtë Kod apo në ligje të veçanta.

3. Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 10 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

3/1. Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe. Kjo gjykatë gjykon me një gjyqtar akuzat penale kundër funksionarëve, sipas nenit 75/a, të këtij Kodi, për vepra penale të ndryshme nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 10 vjet.

(...)

Ndërsa neni 75/a i K.Pr.Penale “Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”, përcakton:

“Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon:

a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;

b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.”

Nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme arrihen në përfundimin mbi kriteret e ligjit material dhe procedural penal përcaktues për dallimin ndërmjet krimin dhe kundërvajtjes penale, si dhe ndërmjet krimin të rëndë e atij jo të rëndë, e që kanë të bëjnë me llojin e marrëdhënies juridike që cenohet, llojin e dënimit, masën e dënimit, gjykatën kompetente nga pikëpamja lëndore dhe trupën gjykuese të caktuar nga ligji për gjykimin në themel, në varësi të llojit dhe të masës së dënimit.

Në rastin konkret, referuar dispozitës penale përkatëse që paditësit janë akuzuar, neni 257/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal, referuar mënyrës, në të cilën pretendohet të jetë kryer vepra penale, nëpërmjet deklaramit të rremë, llojeve të dënimeve të parashikuara nga kjo dispozite penale, dënim me gjobë ose me burgim, masës së dënimit me burgim, që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

parashikon kjo dispozitë, deri në tre vjet dhe duke qenë se kjo vepër penale përfshihet në kompetencën lëndore të gjykimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, e që shqyrtohet në themel me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, rezulton se, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një krim të rëndë.

Në përcaktimin e kësaj krimi si jo të rëndë, ky kolegji ka parasysh edhe përcaktimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara "Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar", miratuar më 12 deri më 15 dhjetor 2000 në Palermo Itali dhe e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 8920, datë 11.7.2002. Sipas nenit 2, shkronja "b" të kësaj konvente: "(b) *"Krim serioz"* nënkupton atë akt që përbën një vepër penale të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë."

Ashtu siç drejt ka evidentuar pala paditëse, krimet e rënda, sipas përcaktimeve të neneve 1, 29, 31 dhe 32 të Kodit Penal si dhe përcaktimeve të neneve 13 e 75/a të Kodit të Procedurës Penale, janë ato të cilat ligjvënësi, në analizë të gjendjes së kriminalitetit dhe të politikës penale, i ka përfshirë në kompetencën lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda, apo të asaj kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe krimet e tjera, të cilat janë në kompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, por për të cilat Kodi Penal, parashikon vetëm dënimin me burgim, me një masë dënimi mbi 10 vjet burg.

Gjykata e Apelit, duke mos e konsideruar si të rëndë krimin për të cilin akuzohen paditësit ***** e *****, çmon ta ndalë këtu arsyetimin e saj, pasi ky konkluzion është rrethanë e mjaftueshme për t'i cilësuar si të pambështetur ligjërisht disponimet e Prokurores së Përgjithshme për pezullimin e paditësve nga detyra, për mosvërtetim të njërit prej kushteve kumulative që kërkon neni 151, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" (krim i rëndë dhe i kryer me dashje)

Në këto kushte, në zbatim të urdhërimeve të shkronjës "a", pika 1, e nenit 40 të ligjit nr. 49/2012, aktet administrative, vendimet Nr. 140, datë 11.05.2018 dhe Nr. 141, datë 11.05.2018, të Prokurores së Përgjithshme, për pezullimin nga detyra të prokurorëve ***** e *****, duhen shfuqizuar si të paligjshëm.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

<?xml:namespace prefix = o ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office"

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 40, pika 1, germa "a" të ligjit Nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Gjykata Administrative e Apelit Tirane

Vendosi:

1. Pranimin e padisë. <?xml:namespace prefix = o ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office">
2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 140, datë 11.05.2018 dhe nr. 141, datë 11.05.2018 të Prokurores së Përgjithshme për pezullimin nga detyra të prokurorëve ***** dhe *****.
3. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur, Prokuroria e Përgjithshme.
4. Kundër vendimit mund të ushtrohet rekurs përpara Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.